**KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH**

Sot më datë 09 01/2023 (dymijë e njëzet e tre),

**Alessia Vogli**, e bija e Gazmend-it e lindur në Peqin në datën 22/10/1995 dhe banuese në Lgj: "Teqe", Rr: " Shqyri Myftiu", në cilësinë e ortakut të shoqërisë THEMATIC INFORMATION BROADCASTING OPERATOR sh.p.k me NUIS: M29718102E sipas ekstraktit bashkëlidhur kësaj kontrate, përfaqësuar në këtë kontratë me anë të Prokurës së Përgjithshme me Nr. Rep 4451 dhe Nr. Kol 1634 datë 03/12/2022 nga Gazmend Vogli i lindur në datë 26/09/1967 ne Peqin i cilësuar këtu e në vijim si **"Shitesi"**;

**Iris Zaçellari,** e bija i Asqeri-ut dhe e Mimoza, lindur në Vlorë, më 03/08/1983 dhe banues në Tiranë me adresë në Rr: "Him Kolli" Nd.9, H3, Ap.23, Njësia Bashkiake Nr. 10, me zotësi të plotë juridike për të vepruar i identifikuar me kartën e identitetit me numër personal I35803063L; e cilësuar këtu e në vijim si **"Blerësi"**.

Të cilësuara vecmas dhe bashkërisht si **"Palët"**.

Duke qënë se

Shitësi Alessia Vogli zotëron kuota të shoqërisë THEMATIC INFORMATION BROADCASTING OPERATOR sh.p.k me NUIS: M29718102E që përfaqësojnë 100% (njëqind pikë përqindje) të kapitalit themeltar të shoqërisë;

Shitësi dëshironë të shesë kuotat e shoqërisë Blerësit me objektivin e përmirësimit të aktivitetit tregtar të saj, rritjen dhe zgjerimin e bazës së tregut në të cilin operon dhe thithjen e kapitaleve financiare nga palë të treta, qofshin këto subjekte financiare bankare ose subjekte financiare jo banka;

Me qëllim sjelljen e ideve të reja dhe një fryme të re kontrolli mbi administrimin dhe veprimtarinë tregtare të shoqërisë;

Me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë palët vendosin të redaktojnë dhe nënshkruajnë kontratën si më poshtë vijon:

**Neni 1**
**Qëllimi dhe objekti kontratës**

1. Qëllimi i kontratës është kalimi i pronësisë së sendeve të luajtshme të patrupëzuara, të cilat zotërohen në mënyrë të plotë dhe të pacënuar, nga Shitësi tek Blerësi.
2. Objekti i kontratës është kalimi i pronësisë së 1 kuote, të barabartë me 100% (njëqind pikë përqindje) të kapitalit themeltar të shoqërsië THEMATIC INFORMATION BROADCASTING OPERATOR sh.p.k me NUIS: M29718102E e cila zotërohet nga ortaku **Alessia Vogli** në favor të **Iris Zaçellari** në cilësinë e blerësit.
3. Pronësia e shitësit mbi kuotën objekt kontrate vërtetohet nga Ekstrakti i thjeshtë i shoqërisë THEMATIC INFORMATION BROADCASTING OPERATOR sh.p.k me NUIS: M29718102E i të njëjtës datë me datën e nënshkrimit të kësaj kontrate dhe pjesë përbërëse dhe e pandashme e saj.

**Neni 2**
**Çmimi dhe pagesa**

1. Palët kanë rënë dakord që çmimi i shitjes së objektit të kontratës, sipas përcaktimeve të pikes 2 të nenit 1 të saj të jetë i barabartë me 400.000 ( katërqind mijë) Lekë ose në vlerën takuese të shumës së mësipërme në Euro dhe më konkretisht 3510 (tre mijë e pesëqind e dhjetë) EURO.
2. Vlera e mësipërme do të kalojë në llogarinë bankare me Nr. AL50202110130000000003889610 dhe me SËIFT: SGSBALTX
3. Shuma që përbën çmimin e përcaktuar për kalimin e pronësisë së kuotës do të derdhet në llogarinë e Shitësit sipas ekstremiteteve bankare bashkëlidhur dhe pjesë e pandashme e kësaj kontrate jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga nënshkrimi i kësaj kontrate.

**Neni 3**
**Pronësia dhe transferimi i kuotave**

1. Shitësi garanton Blerësin se kuotat janë te lira nga çdo detyrim ligjor dhe financiar ndaj të treteve dhe për çdo pretendim që mund të ngrenë të tretët Shitësi është i gatshëm dhe i detyruar të paraqitet me kërkesën e Blerësit para të gjithë organeve gjyqësore dhe administrative për të mbrojtur të drejtën e tij si pronar i ligjshëm i këtyre kuotave.
2. Blerësi përjashtohet nga çdo detyrim administrative financiar apo ligjor ndaj vetë shoqërisë në cilësinë e ortakut, apo ndaj të tretëve, për detyrime që rrjedhin nga aktiviteti tregtar i shoqërisë deri në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate. Shitësi deklaron se të gjitha detyrimet e mëparshme të shoqërisë ndaj të tretëve do të përballohen nga kuota e zotëruar prej tij, dhe të drejtat që rrjedhin prej saj, në shoqëri.
3. Pala shitëse merr përsipër të gjitha detyrimet që rrjedhin nga cilësia e ortakut të palës blerëse deri në regjistrimin e kësaj kontrate në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 4**
**Zgjidhja e mosmarrveshjeve**

1. Të gjitha mosmarëveshjet që mund të lindin mes palëve gjatë zbatimit të kësaj kontrate ose pas përfundimit të saj por që rrjedhin nga kjo kontratë, do zgjidhen me arbitrazh. Institucioni i arbitrazhit do të jetë Dhoma Shqiptare e Arbitrazhit. Rregullat e arbitrazhit do të jenë rregullat proceduriale të Dhomës Shqiptare të Arbitrazhit. Mosmarrveshjet do të gjykohen nga një gjyqtar i vetëm, i cili do të caktohet nga Dhoma Shqiptare e Arbitrazhit, sipas procedurave të këtij institucioni për caktimin e arbitrit të vetëm. Legjislacioni që do të zbatohet gjatë gjykimit në arbitrazh do të jetë legjislacioni shqiptar.

Sa parashikuar në dispozitat kontraktuese të mësipërme, në përputhje me nenin 686 te Kodit Civil Shqiptar, palët deklarojnë se pranojnë dhe miratojnë veçmas Nenet 2, 3 dhe 4 të saj.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësi, zhvishet nga pronësia e 1 (një) koute me perqindje 100% (njëqind pikë përqindje) të kapitalit themeltar dhe Bleresi bëhet zotërues i 1 (një) koute me perqindje 100% (njëqind pikë përqindje pikë përqindje) të kapitalit themeltar.

| SHITËSI | BLERËSI |
|---|---|
| **Alessia Vogli** | **Iris Zaçellari** |
| Përfaqësuesi me Prokurë të Posaçme | |
| **Gazmend Vogli** | |
| Gazmend Vogli | Iris Zacellari |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MARGENA U. ÇELA
ADRESA Astrit BALLUKU
TEL: 695244272

# PROKURË E PËRGJITHSHME

**Nr. repertori: 4451** **Nr. koleksioni: 1634**

**Tirane më 03/12/2022**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

A2022053120183786688

A2022053120183786688

**PROKURE E PERGJITHSHME**

Para meje **MARGENA U. ÇELA**, Noter ne qytetin Tiranë, ne adrese: Astrit BALLUKU, u paraqit personalisht:

**(E) PERFAQESUAR**: Alessia Vogli, me atësi Gazmend, lindur më 22/10/1995 në Peqin dhe banuese ne Tiranë ne adresen: Medar Shtylla; Nd. 1845; H. 0; Ap. 071; Njësia Administrative Nr. 5; Tiranë; 0000; Tiranë, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga Leternjoftim ID me Nr. 032028560 dhe Nr.Personal J56022012V.

E cila me kerkoi hartimin e kesaj prokure te pergjithshme, ne baze te nenit 64, 67 e vijues te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise.

"Emeroj si perfaqesues te pergjithshem babain tim **Gazmend Vogli**, lindur me 26/09/1967 ne Peqin, Elbasan dhe banues ne Tiranë, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar me Leternjoftim ID me Nr. 033818231, i jap te drejte dhe kompetence te plote ne emrin tim:"

- Te paraqitet prane cdo institucioni shteteror, publik apo privat, zyrat e regjistrimit te pasurive te paluajtshme, bashki, komune, zyrat e gjendjes civile duke pasur te drejte te depozitoje, terheqe dhe nenshkruaje dokumente ku kerkohet prania ime, te beje aplikime, kerkesa, te beje pagesa, te regjistroje pasuri te luajtshme apo te paluajtshme ne pronesine time etj.
- Te paraqitet prane QKR apo te kryej online cdo veprim te nevojshme bere bizneset e mija duke pasur te drejta te plota te bej cdo ndryshim pa kufizim sikur te isha une aty, gjithashtu ka te drejta te plota te mbylli Niptin ne emrin tim apo te hapi nje Nipt ne emrin tim.
- Perfaqesuesi im ka te drejta te plota te paraqitet prane Autoritetit te Mediave per te kryer cdo veprim te nevojshem pa kufizime duke nenshkruar apo bere kerkesa te nevojshme duke depozituar apo terhequr dokumenta ku kerkohet prania ime.
- Perfaqesuesi im ka te drejta te plota te kryej shitjen e plote apo te pjesshme te aksioneve te mija ne Shoqerine Thematic Information Broadcasting Operator sh.p.k me NUIS M29718102E duke e gjetur vete bleresin dhe duke vendosur vete per kushtet e kontrates.
- Perfaqesuesi i pergjithshem ka te drejte te paraqitet prane cdo zyre noteriale, per te nenshkruar ne emrin tim kontrata dhurimi apo shitje te pasurive te mia te luajtshme apo te paluajtshme, duke pasur te drejte te gjeje palen blerese, te nenshkruaje kontratat me kushtet qe ai i konsideron te arsyeshme, si dhe te terheqe cmimin e shitjes.
- Perfaqesuesi i pergjithshem ka te drejte t'i administroje pronat e mia, t'i mirembaje dhe t'i perdore duke pasur te gjitha te drejtat e administrimit, si dhe te drejten te nenshkruaje cfaredolloj akti per administrimin e pronave.
- Perfaqesuesit i jap te drejte dhe kompetence te plote, edhe ***ne mungesen time,*** te me perfaqesoje prane cdo banke te Republikes se Shqiperise, per te perfunduar cdo veprim te nevojshem, duke plotesuar, depozituar, terhequr dhe nenshkruar te gjithe dokumentacionin perkates per perfundimin e veprimeve bankare si terheqje, pagesa, depozitime, transferta, change, mbyllje llogarie etj per llogarite e mija personale apo ato te biznesit.
- Perfaqesuesi im ka te drejte te paraqitet prane cdo zyre noteriale, per te nenshkruar Kontrata Komisioni, , Kontrata porosie, Kontrata qiraje, kontrata huaperdorje, kontrata pjestimi, revokim kontratash, deklarata noteriale, likuidimi apo te formave te tjera, kontrata sipermarrje, kontrata shkembimi, kontrata premtim shitje, si dhe cdo akti noterial qe ka lidhje me pasurite e mia te luajtshme dhe te paluajtshme.

A2022053120183786688

- Perfaqesuesi i pergjithshem ka te drejte te gjeje, emeroje, dhe autorizoje perfaqesues te tjere plotesues, Perfaqesues te pergjithshem apo te posacem, avokate etj, duke u dhene atyre tagra dhe te drejta perfaqesimi per te vepruar per te gjitha apo pjese te drejtave te cituara me siper ashtu sic ai do ta gjykoje te arsyeshme dhe te nevojshme per pronat e tona.

Prokura e pergjithshme u redaktua nga une Noteri ne kater kopje te njejta, ju lexua te perfaqesuares me ze te larte dhe qarte e cila e kuptoi permbajtjen e saj dhe meqenese shpreh vullnet te lire e te plote e nenshkroi ate ne pranine time dhe une noteri e vertetoj sipas ligjit.

**(E) PERFAQESUAR**

Alessia Vogli

Alessia Vogli

**NOTER**

MARGENA U. ÇELA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

# EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | | |
|---|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | M29718102E | |
| 2. Data e Regjistrimit | 18/11/2022 | |
| 3. Emri i Subjektit | THEMATIC INFORMATION BROADCASTING OPERATOR | |
| 4. Forma ligjore | SHPK | |
| 5. Data e themelimit | 07/11/2022 | |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 07/11/2022 | |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Elbasan Peqin Elbasan, Peqin, Lagjja "Xhami", Bulevardi "Mustafa Gjinishi", Godine 4 kateshe, nr. 2 | |
| 8. Kapitali | 100.000,00 | |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 1,00 | |
| 9. Objekti i aktivitetit | Ofrimi i shërbimeve Televizive dhe të Radios | |
| 10. Administratori/ët | Rezart Kthupi | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 07/11/2022 | Deri: 06/11/2023 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | 1. Administratori/administratorët e shoqërisë pa miratimin me vendim nga ana e Asamblesë së Përgjithshme nuk mund të: a. Lidhin kontrata, marrin përsipër detyrime apo shlyejnë pagesa të cilat tejkalojnë vlerën prej 5.000.000 (pesë milion) lekësh apo ekuivalentin e kësaj shumë ne monedhë të huaj apo në cdo formë tjetër të konvertueshme. b. Lidhin kontrata, marrin përsipër detyrime apo shlyejnë pagesa, të cilat, gjatë kohëzgjatjes 1 vjecare e ngarkojnë shoqërinë me detyrime që tejkalojnë vlerën prej vlerën prej 5.000.000 (pesë milion) | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

| | | |
|---|---|---|
| | lekësh apo ekuivalentin e kësaj shumë ne monedhë të huaj apo në cdo formë tjetër të konvertueshme. | |
| 12. Ortakët | AlessiaVogli | |
| 12.1 Vlera e kapitalit | Para: 100.000,00 | Natyre: |
| 12.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 100,00 | |
| *Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)* | | |
| 12.4 Komente (nëse ka) | | |
| 13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | | |
| 14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: Tv Klaudiana<br>E-Mail: rezartkthupi@gmail.com<br>Telefon: 0697014504 | |
| 15. Statusi: | Aktiv | |

Lista e Dokumenteve:
Statuti (nese eshte hartuar si dokument i ndryshem nga akti i themelimit)
Akti i emerimit te organeve te shoqerise, nese nuk perfshihet ne aktet e tjera
Akti i themelimit

Regjistrimi Fillestar: CN-035590-11-22

## HISTORIKU I REGJISTRIMIT

| Data e regjistrimit | Ndryshimi i te dhenave te regjistruara |
|---|---|
| 12/12/2022 | Numri i ceshtjes: CN-044542-12-22<br>Arsyet e hapjes se ceshtjes: Miratimi i ndryshimit te emrit tregtar.<br>Vlera e aksionit ishte "" u be **"100.000,00"**<br>Data nga ishte "" u be **"07/11/2022"**<br>Emri Tregtar ishte *("Tibo TV")* u be **("Tv Klaudiana")**<br><br>Lista e Dokumenteve:<br>Vendim i asamblese se pergjithshme |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

Datë: 24/12/2022

_________________________
Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date:2022/12/24 11:25:41 +01:00
M29718102E2022122411253179
3006

*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)*